



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

---

PLANI  
I  
PUNËS SË KKSBB-SË PËR VITIN 2024

KLINË – 2024

Hyrje

Në komunën tonë për vitin 2024, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB), funksionin e saj e bazon në Udhëzimin Administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi. Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohet mënyra e themelimit, përbërja, objektivat, detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi.

Në Planin Vjetor të Punës së KKSBB-së përcaktohen objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSBB-së në përmbushje të qëllimit të funksionimit të këtij mekanizmi. Ky plan synon që të identifikojë qëllimet, aktivitetet dhe rezultatet, përkatësisht caktimin e përgjegjësiave për kryerjen e detyrave të përcaktuara me udhëzimin administrative për KKSBB-në.

Roli i KKSBB-së në komunën tonë ka rëndësi të veçantë sepse identifikon dhe mbledh shqetësimet e qytetarëve nëpërmjet përfaqësuesve të bashkësive etnike, fetare, sociale, profesionale dhe ato shqyrtohen bashkë me përfaqësuesit institucional të komunës dhe të organeve të sigurisë dhe tentohet të zgjidhen në dobi të qytetarëve.

Bazuar në udhëzimin administrativ Nr.27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, KKSBB duhet të mbajë së paku gjashtë (6) takime gjatë vitit, KKSBB-ja mund të mbledhet edhe me shpesh në bazë të nevojave dhe kërkesave të anëtarëve të saj.

Në këto takime shqyrtohen probleme të cilat synojnë përmirësimin e sigurisë së qytetarëve.

**PLANI VJETOR I PUNËS PËR KËSHILLIN KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI  
PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2024**

Nr.	Muaji	Çështjet që shqyrtohen	Përgatit	Shqyrton 1	Shqyrton 2	Informon	Vërejtje
-----	-------	------------------------	----------	------------	------------	----------	----------

1.	<b>Shkurt</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vlerësimi i përgjithshëm i sigurisë në territorin e Komunës së Klinës.</li> <li>2. Ushtrimi i kontrollit më të shpeshta të trafikut rrugor për të zvogëluar aksidentet me fatalitet.</li> <li>3. Organizimi i trajnimit për mbrojtje nga zjarri me nxënësit e shkollave.</li> <li>4. Trajtimi i qenve endacak.</li> </ol>	Koordinatori i KKSB-së Policia e Kosovës  Drejtoria përkatëse për shërbime publike dhe DKA	Anëtarët e propozuar për KKSB- ës	KKSB-së	Kuvendin e Komunës	
2.	<b>Prill</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Analizimi i vjedhjeve në territorin e Komunës së Klinës .</li> <li>2. Mungesa e trotuareve dhe shenjave sinjalizuese në territorin e Komunës.</li> <li>3. Identifikimi dhe lirimi i hapësirave publike konkretisht trotuareve.</li> </ol>	Drejtoria përkatëse për shërbime publike  Koordinatori KKSB- së Policia e Kosovës dhe Drejtoria e Arsimit	Kryetari i Komunës  KKSB-së	KKSB-së	Kuvendin e Komunës	
3.	<b>Qershor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diskutim për aktivitete e organizuara nga Drejtoria e Arsimit për maurantet.</li> <li>2. Prishja e rendit dhe qetësisë publike nga lokalet e natës dhe personat e pa përgjegjshëm.</li> <li>3. Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri gjatë sezonit veror dhe vërshimet gjatë vitit.</li> <li>4. Plani operativ për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve dhe dasmave.</li> </ol>	Drejtoria përkatëse për shërbime publike  Koordinatori i KKSB-së  Policia e Kosovës Anëtarët e KKSB-së Drejtoria e Arsimit	Kryetari i Komunës  KKSB-së,	KKSB-së	Kuvendin e Komunës	
4.	<b>Gusht</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Trajtimi i mbrojtjeve të pyjeve nga dëmtuesit ilegal.</li> <li>2. Informatë për fillimin e procesit mësimor dhe çështja e sigurisë nëpër shkolla.</li> <li>3. Informatë dhe analizë nga policia e Komunës për çështjen e vjedhjeve dhe sigurisë së përgjithshme.</li> <li>4. Identifikimi i hapësirave për qasjen e personave me nevoja të veçanta.</li> </ol>	DBPZHR Drejtoria e Arsimit Policia e Kosovës FSK-ja dhe Drejtoria përkatëse për shërbime publike	Kryetari i Komunës  KKSB-së	KKSB-së	Kuvendin e Komunës	

5.	<b>Tetor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Organizimi i fushatave vetëdijesuse përmes aktiviteteve rekreative, kulturore për përmirësimin e komunikimit ndëretnik dhe ndër fetar</li> <li>Siguria në trafik.</li> <li>Raportimi dhe parandalimi i dhunës në familje.</li> <li>Informatë nga Drejtoria e shërbimeve publike lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit.</li> </ol>	DKA Përfaqësuesit e organizatave publike dhe private Policia e Kosovës FSK-ja Drejtoria përkatëse për shërbime publike	Kryetari i Komunës KKSB-së DSHP,	KKSB-së	Kuvendin e Komunës	
6.	<b>Dhjetor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Vetëdijesimi për rrezikun e përdorimit të mjeteve piroteknike.</li> <li>Identifikimi i vendeve ku dyshohet se të rinjtë tonë përdorin substanca narkotike.</li> <li>Masat për parandalimin e lëmshë-kërkuesit .</li> <li>Përgatitja e planit të veprim për KKSB për vitin 2025.</li> </ol>	Anëtarët e KKSB-së Koordinatori i KKSB-së  Anëtarët e KKSB-së FSK-ja Policia e Kosovës	Policia KKSB-së	KKSB-së	Kuvendin Komunës	

Përveç këtyre temave Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, do të shqyrtoj edhe tema tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët, Policinë e Kosovës dhe Komunën e Klinës .

### KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-3472 /2024  
Klinë, me 01, 02 /2024



**KRYESUESI,**  
**Fadil Gashi**